



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË
QËNDRA E ARTIT DHE KULTURËS

VENDIM

Nr. 97 datë 25 . 09 .2025

“PËR MIRATIMIN E
VENDOSJES SË BUSTIT TË Z. LLAZAR (ZAI) FUNDO NË QYTETIN E KORÇËS”

Bazuar në dispozitat e Ligjit nr.10352, datë 18.11.2010 “Për Artin dhe Kulturën” (i ndryshuar), nenit 9 pika 1.2, gërma c) dhe nenit 54 të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, VKB 151 dt. 31.10.2024 “Për miratimin e emërimit të një sheshi në territorin e Bashkisë Korçë në nder të Zai Fundo”, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur

VENDOSI

1. Të miratojë vendosjen e bustit të atdhetarit, patriotit, aktivistit të shquar Z. Lllazar (Zai) Fundo, për të nderuar veprimtarinë e tij patriotike, në sheshin e emërtuar me të njëjtin emër, ndodhur midis Bulevardit “Shën Gjergji” dhe rrugës “Evanthi Dvorani”, miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak Korçë nr. 151 dt 31.10.2024.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Qendra e Artit dhe Kulturës, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Territorit dhe Menaxhimit të Kontratave të Infrastrukturës
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Eva NAÇI

Miratuar me 24 vota

Vota Pro 24

Vota Kundër 1

Vota Abstenim 1

Zbardhur më datë 25-09-2025



BASHKIA KURÇE
NR 4506 PROT
DATA 17/09/2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË
QËNDRA E ARTIT DHE KULTURËS

Nr. _____ Prot.

Datë 16.09.2025

RELACION

“PËR MIRATIMIN E
VENDOSJES SË BUSTIT TË Z. LLAZAR (ZAI) FUNDO NË QYTETIN E KORÇËS”

Kryetari I Bashkisë Korçë në zbatim të dispozitave ligjore dhe konkretisht Ligjit nr.10352, datë 18.11.2010 “Për Artin dhe Kulturën” (i ndryshuar), Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, VKB Nr. 85, datë 23.05.2022 “Për miratimin e anëtarëve të Bordit Artistik pranë QAK”, VKB 151 dt. 31.10.2024 “Për miratimin e emërimit të një sheshi në territorin e Bashkisë Korçë në nder të Zai Fundo”, I kërkoi Bordit Artistik në QAK të shqyrtohet propozimi për vendosjen e bustit të atdhetarit, patriotit, aktivistit dhe luftëtarit të shquar Zai Fundo në sheshin e emërtuar me të njëjtin emër, ndodhur midis Bulevardit Shën Gjergji dhe rrugës Evanthi Dvorani, me vendim të Këshillit Bashkiak Korçë nr. 151 dt 31.10.2024.

Bordi Artistik i mbledhur në dt 19.09.2025 pasi morri në shqyrtim propozimin e Kryetarit të Bashkisë Korçë. Në mbledhje u diskutua rreth figurës të z Llazar (Zai) Fundo, i lindur në Korçë në 20.08.1899.

Që në rini tregoi interes për letërsinë, filozofinë dhe idetë e majta progresiste që përfshinë europën në fillim të shekullit XX. U largua për studime në Francë ku u përfshi në rrethin e intelektualëve të rinj. Z Llazar (Zai) Fundo u bë një nga veprimtarët e parë të lëvizjes komuniste shqiptare. Ai shkroi shumë artikuj politikë në gjuhën shqipe dhe frënge të cilat u botuan në revistat dhe gazetat e kohës. Ai një periudhë u largua në Bashkimin Sovjetik ku u bë një kritik i hapur i stalinizmit.

Ka shkruar shumë artikuj dhe ese ku mbrojti idetë e socializmit demokratik duke përkrahur një revolucion pa diktaturë, me liri mendimi dhe kundër dhunës politike. Këto qëndrime e bënë atë të padëshirueshëm për regjimin autoritar të kohës ashtu dhe për udhëheqësit e Partisë Komuniste gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Fundo u kthye në Shqipëri dhe mbajti kontakte me lëvizjen antifashiste, nuk pranoi të bashkëpunonte me Partinë Komuniste të Shqipërisë dhe për këtë shkak u arrestua në vitin 1944 dhe u ekzekutua pa gjyq.

Z Llazar (Zai) Fundo përfaqësonte një brez të rrallë mendimtarësh, mbrojtës i lirisë të fjalës,

pluralizmit dhe dinjitetit intelektual ndaj dhe meriton që në qytetin e Korçës të ketë një bust

Për sa më sipër u diskutua dhe në mbledhjen e radhës së Bordit Artistik të Q.A.K Korçë.

Të gjithë anëtarët e Bordit folën për vlerat e tij patriotike dhe vendosën unanimitisht që busti të vendoset në sheshin e emërtuar me të njëjtin emër në nder të tij.

Sa më sipër bazuar në dispozitat e Ligjit nr.10352, datë 18.11.2010 "Për Artin dhe Kulturën" (i ndryshuar), nenit 9 pika 1.2, gërma c dhe nenit 54 të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, VKB 151 dt. 31.10.2024 "Për miratimin e emërimit të një sheshi në territorin e Bashkisë Korçë në nder të Zai Fundo", i kërkojmë Këshillit Bashkiak të miratojë vendosjen e bustit të atdhetarit, patriotit, aktivistit të shquar z. Llazar (Zai) Fundo, për të nderuar veprimtarinë e tij patriotike, në sheshin e në sheshin e emërtuar me të njëjtin emër, ndodhur midis Bulevardit "Shën Gjergji" dhe rrugës "Evanthi Dvorani", miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak Korçë nr. 151 dt 31.10.2024.

QËNDRA E ARTIT DHE KULTURËS

DREJTORE E PËRGJITHSHME JURIDIKE


DREJTORE


ANXHELA QERAMIXHI (DISHNICA)

ZAMIRA KITA


KRYETARI

SOTIRAQ FILO






PAMJE BALLORE



PAMJE NGA SIPER



BITH GROUP Rruga Enxhep Beutaj, Tiranë 11010	Designer: ENSO NEZIRI Client:	Scale 1:25 Project number 129	Date
---	-------------------------------------	-------------------------------------	------





